

V E N D I M
Nr.460, datë 28.12.1990

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHËRESËN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.1,
DATË 7.7.1989 "PËR ADMINISTRIMIN E KËRKESAVE PËR BANESA DHE PËR
SHPËRNDARJEN E TYRE".**

Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në urdhëresën e Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.7.1989, neni 16 ndryshohet si vijon:

"Sipërfaqet që lirohen nga sistemimi me banesë nga qendra e punës, si dhe nga organet e repartit të Ministrisë së Mbrojtjes Popullore e të Ministrisë së Punëve të Brendshme, mbeten në dispozicion të tyre për të sistemuar punonjësit e tjerë, duke bërë propozimet në organet kompetente që merren me shpërndarjen e banesave, jo më vonë se 20 ditë para datës së lirimit të banesës, kurse sipërfaqet që lirohen nga transfrimi i punonjësve jashtë rrethit, mbeten në dispozicion të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve.

Këshilli popullor i lagjes së qytetit ose këshilli popullor i qytetit, kur nuk është i ndarë në lagje, për banesat që lirohen marrin vendim jo më vonë se 10 ditë para datës së lirimit të tyre".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ADIL ÇARÇANI